



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/02/2022

Lënda: Përcillet kërkesa për informacion e një deputeti të Kuvendit.

DREJTUAR: Znj. Dhurata Frashëri
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare

E nderuar Znj. Frashëri,

Lutemi gjeni bashkëlidhur kërkesën për informacion të përgatitur nga një deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
GENCI GJONÇAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
GRUPI PARLAMENTARI PARTISË DEMOKRATIKE

Lënda: Kërkesë për dhënie informacioni.

Drejtuar: Znj. Dhurata Frashëri
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare

E nderuar Znj. Frashëri,

Në përmbushje të detyrës sime si deputet, si dhe në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “*Statusi i deputetit*”, i ndryshuar, ku specifikohet se: “*Deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së tij, nga ministrat ose nga drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore, si dhe nga drejtuesit e çdo institucioni tjetër në administratën publike ose të qeverisjes vendore. Drejtuesit e institucioneve janë të detyruar t'i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës*”, kërkoj nga ana juaj informacion të plotë dhe të detajuar, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, në lidhje me sa më poshtë:

- i Marrëveshjen e bashkëpunimit dhe çdo korrespondencë ndërmjet institucionit tuaj me shoqërinë Air Albania shpk, lidhur me ofrimin e shërbimit të fluturimeve të posaçme më avioin charter për Kryeministrin dhe çdo zyrtar tjetër (*dokumentacioni në kopje të njehsuar me origjinalin si dhe çdo korespondencë/procesverbal lidhur me marrëveshjen*);
- i Bazuar në të dhënat e tregut, ku vlera e udhëtimeve me avion charter varion minimalisht nga 15 mijë euro ora, cila është arsyeja e përzgjedhjes nga institucioni juaj të shërbimit të udhëtimeve nëpërmjet fluturimeve me avion charter për Kryeministrin?
- i Sa është afati i kohëzgjatjes së marrëveshjes së bashkëpunimit për ofrimin e shërbimit të fluturimeve me avion charter ndërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe shoqërisë Air Albania shpk?

- i Si është llogaritur tarifa e shërbimit dhe çfarë zërash përfshin?
- i Sa është numuri i udhëtimeve me avion charter dhe vlera totale e paguar nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare nga momenti i hyrjes së fuqi të Marrëveshjes deri sot?
- i Listoni në mënyrë shteruese të gjitha udhëtimet e kryera me avion charter nga ana e Kryeministrit apo çdo zyrtar tjetër bazuar në marrëveshjen e mësipërme, duke përcaktuar për çdo rast vlerën e çdo udhëtimi si dhe vlerën e zërave përkatës së tarifisë së shërbimit për çdo udhëtim, e cila përfshin koston e karburantit, taksat aeroportuale dhe përpunimi në tokë (ground handling), apo çdo kosto tjetër.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë njehsuar me origjinalin dhe në shkresën përcjellëse të listohet çdo dokument me emërtimin e tij dhe numrin e faqeve përkatëse.

Kjo kërkesë për informacion bazohet edhe në nenin 7 të Kushtetutës, ku sanksionohet parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Nën dritën e këtij parimi, merr përparësi funksioni i kontrollit parlamentar, i cili nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë si dhe nxjerrjen e përgjegjësi, sipas rasteve konkrete. Të gjitha çështjet që përmbajnë në vetvete një interes publik përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar. Në këtë rast, ligjshmëria dhe transparenca në procedurat e përdorimit të fondeve dhe pasurive publike, është një kërkesë e domosdoshme për mbrojtjen e interesave të shtetit, si një nga detyrat themelore të organeve publike.

Duke e vlerësuar si thelbësore për respektimin e standardeve të shtetit të së drejtës, jo vetëm garantimin e parimit të ligjshmërisë, por mbi të gjitha qeverisjen transparente, mbetemi në pritje të informacionit tuaj, brenda afatit ligjor 15 ditor.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETI

ORJOLA PAMPURI

